



THIRRJE PËR ANKETUES

Rreth projektit:

IKS, në kuadër të projektit “Mbështetje për Koalicionin e Drejtësisë Sociale”, po kërkon katër (4) anketues, si pjesë e hulumtimit me punonjësit e sektorit privat në Kosovë dhe vlerësimin e njohurive të tyre mbi ligjet e lidhura me punën.

Gjetjet e këtyre vizitat do t'u shërbejnë vendimmarrësve për të identifikuar aspektet më problematike të zbatimit të ligjeve bazë në fushën e punës dhe punësimit ,dhe në të njëjtën kohë shërbejnë si udhëzues për agjencitë e zbatimit të ligjit në lidhje me problemet e identifikuara në terren.

Kjo anketë organizohet brenda kornizës së projektit “Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe dialogut social në Kosovë” i cili implementohet nga UNOPS dhe financohet nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë".

Kriteret për aplikim:

- Kualifikim universitar bachelor apo të jenë në përfundim të studimeve;
- Aftësi të shkëlqyera në shkrim dhe komunikim të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Vullnet dhe motivim për bashkëpunim;
- Përvoja e punës është e preferueshme;

*Njohuria rreth ligjit të punës në Kosovë dhe të drejtave të punëtorëve është përparësi.

Anketimi në terren do të zgjasë nga data 30 gusht deri më 30 shtator 2021. Kandidatët e interesuar duhet të dëgojnë CV-në dhe një letër motivuese në email adresën:

mrike_sefaj@iksweb.org.

Thirrja do të jetë e hapur për një javë, duke filluar nga 17.08.2021, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është 23.08.2021.